



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:247976

Datë: 23.12.2021

Numri i dokumentit: 02547174

C. nr.1020/21

Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, në çështjen juridike të paditësit Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (K.) me seli në P.Rr “Bulevardi Bill Klinton nr.3 Ndërtesa e Elektrokosovës Kati II numër 5,P. 10000, Republika e Kosovës, kundër të paditurit S.F. M. nga fshati L., Komuna e Malishevës, për kompensimin e dëmit material, vlera 164.08 Euro, jashtë shqyrtimit kryesor me datë 23.12.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR Padia e paditësit Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (K.) me seli në P. Rr “Bulevardi Bill Klinton nr.3 Ndërtesa e Elektrokosovës Kati II numër 5,P. 10000, Republika e Kosovës, e ushtruar me datë 21.10.2021, kundër të paditurit S.F.M. nga fshati L., Komuna e M., për kompensimin e dëmit material, vlera 164.08 Euro.

A r s y e t i m

Paditësi i lartpërmendur, në këtë gjykatë me datë 21.10.2021, kanë parashtruar padinë dhe kërkesëpadinë kundër të paditurit të lartcekur për kompensimin e dëmit material.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë i ka dërguar të paditurës Aktvendimin për përgjigje në padi, me datë 23.11.2021, së bashku me padinë dhe provat e padisë, të pranuar nga bashkëshortja e të paditurit me datë 26.11.2021, mirëpo deri më tani i padituri nuk ka parashtruar përgjigje në padi

Paditësi nëpërmjet zyrës ligjore, me datë 10.12.2021, përmes parashtrësës për tërheqjen e padisë ka njoftuar gjykatën se lidhur me padinë e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 12.10.2021, për kompensimin e dëmit material në vlerën prej 164.08 euro, në shifrën DGJ-..., ju njoftojmë se i padituri e ka përmbushur obligimin e Rikthimit të Humbjeve me datën 01.12.2021, e cila u vërtetua në bazë të transaksionit të konsumatorit, ku edhe i padituri prezantoi provat e të cilat edhe u vërtetuan nga ana e paditëses andaj e bëjmë tërheqjen e padisë dhe kërkesëpadisë, nuk kërkojmë Aktvendim të Veçantë. Po ashtu për këtë padi është realizuar edhe pagesa e taksës gjyqësore në shumë prej 20€.

Si provë ka dorëzuar kopjen e fletëpagesës së konsumatorit me shifrën D., të datës 01.12.2021 dhe kopjen e pagesës së taksës gjyqësore për padi-S. M..

Duke u bazuar në parashtresën e paditësit dhe meqenëse e paditura deri më tani nuk ka paraqitur përgjigje në padi edhe përkundër se e njëjta siç u cek më lartë me datë 26.11.2021, e ka pranuar Aktvendimin për përgjigje në padi, Gjykata konform nenit 261 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë.
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr. 1020/21, datë 23.12.2021

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.